




Pranimi / Dorezuar Prilipen / Prilipato Received / Delivered		05.01.2022		viti god year
Organ / Institucija Org / Insti	Nr Prot Pril / Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity	
SKM/SJKK	11/2022		1/4	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.908/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Malësore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Clirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.908/2021 të datës 08.11.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Hajzer Salihu avokat nga Prishtina, kundër Vendimit Nr.34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.01.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Shfuqizohet Vendimi Nr.34/39 i datës 13.10.2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.**
- II. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç është përcaktuar në pikën një (1) të dispozitivit.**
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 08.11.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5329/2021 të regjistruar me numër A.nr.908/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes të cilit është shfuqizuar Vendimi Nr.13/59 i datës 21.01.2021 i Qeverisë së Kosovës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 19.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Sekretariati Koordinues pranë Zyrës së Kryeministrit. Këshilli më datë 08.12.2021, ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 5873/2021 se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh natyrën e çështjes, me Vendimin Nr.64/2021 të datës 20.12.2021 të Kryesuesit të KPMSHCK-së, është vazhduar afati për vendosje të ankesës A.nr.908/2021 të datës 08.11.2021 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën më nr.prot. 5329/2021 të datës 08.11.2021 të parashtruar në KPSHCK-ë; Autorizimin për përfaqësim të datës 21.10.2021, Vendimin Nr.16/35 të datës 09.03.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kërkesën për transferimin e ankuesit me nr.prot: 01/1395 të datës 16.09.2020 të Ministrit të MEA, Përgjigjen ë kërkesë me nr. prot: 541 të datës 26.09.2020, Propozim Vendimin e datës 06.01.201 pa te dhëna dhe nënshkrim, Vendimin Nr.12/33 të datës 28.09.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimin Nr.13/59 të datës 21.01.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimin Nr. 34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kërkesën për rikthim të ligjshmërisë të datës 19.10.2021, Kërkesën për vazhdimin e mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm të MEA-së, e-mailin e datës 28.10.2021 të F.K për T.M. nga fq 1/5, Formularin me komente të Ministrit për Vlerësimin e Performances vjetore të Rezultateve në punë të Zyrtarit të Lartë Drejtues me numër protokolli 193 të datës 11.03.2019, Formularin me komente të Ministrit për Vlerësimin e Performances vjetore të Rezultateve në punë të Zyrtarit të Lartë Drejtues me numër protokolli 1057/1 të datës .02.06.2020; Formularin me komente të Ministrit për Vlerësimin e Performances vjetore të Rezultateve në punë të Zyrtarit të Lartë Drejtues me nr.prot:1057/2 të datës 29.08.2020; Formularin me komente të Ministrit për Vlerësimin e Performances vjetore të Rezultateve në punë të Zyrtarit të Lartë Drejtues me nr.prot me nr.prot: 329 të datës 29.06.2020, përgjigjen në ankesë më nr.prot: 5873/2021 të datës 08.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi që ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstaton se janë përmbushur kërkesat ligjore që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Qeveria e Republikës së Kosovës, *sepse:*

Bazuar në administrimin e provave të lëndës, është konstatuar se ankuesi me Vendimin Nr.16/35 të datës 26.03.2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është emëruar Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me mandat tre (3) vjeçar. Ndërsa, me Vendimin Nr.12/33 të datës 28.09.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesi nga pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është transferuar në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, për periudhën kohore brenda mandatit të përcaktuar me Vendimin Nr.16/35 të datës 09.03.2018.





Bazuar në kërkesën e Ministrit të Ministrisë për Ekonomi dhe Ambientit të datës 06.01.2021, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 42 dhe 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ankuesit i ka vazhduar mandatin e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit edhe për katër (4) vite tjera, duke filluar nga data 10.03.2021.

Disa muaj me vonë, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 13.10.2021 ka nxjerr Vendimin Nr.34/39 të datës 13.10.2021 dhe ka shfuqizuar Vendimin Nr.13/59 të datës 13.10.2021, përmes të cilit ankuesit i ishte vazhduar mandati i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, me ç'rast të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës respektivisht mandati i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Kundër Vendimit Nr.34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesi fillimisht me datë 19.10.2021, ka parashtruar kërkesë për rikthim të ligjshmërisë pranë Ministres së Ministrisë për Ekonomi. Pas heshtjes se kësaj të fundit, ankuesi me datë 08.11.2020 ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil me pretendimet ankimore: se Vendimi Nr.34/39 i datës 13.10.2021 i Qeverisë së Kosovës karakterizohet me shkelje procedurale dhe ligjore dhe si tillë është në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke shtuar me tej se vendimi i kundërshtuar po ashtu nuk përmban fare arsyetimin dhe pjesën përmbyllëse ashtu siç përcaktohet me nenin 47 paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore ka analizuar Vendimin e Nr.34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Qeveria e Republikës së Kosovës me rastin e nxjerrjes se vendimit të kontestuar nuk ka respektuar kërkesat ligjore sipas nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku është përcaktuar se: *1. Akti administrativ i shkruar përmban ën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). ..."* respektivisht në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, Kolegji konstaton se vendimi në fjalë përbëhet vetëm prej pjesës hyrëse dhe dispozitivit, kështu që i njëjti nuk përmban pjesën arsyetuese e cila do i mundësonte palës ta kuptoj aktin administrativ, rrjedhimisht vendimi i kontestuar nuk përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar si dhe bazën ligjore për vendosje dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret.

Po ashtu, Vendimi Nr.34/39 i datës 13.10.2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk përmban këshillën juridike si element i detyrueshëm i aktit administrativ ashtu siç parashihet me nenin 47 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme





Administrative ku përcaktohet se: "pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike)", andaj, nisur nga ky konstatim dhe duke marrë parasysh se nuk ka ekzistuar asnjëra nga rrethanat ligjore sipas nenit 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vlerëson se të metat e tilla të aktit administrativ e bëjnë të paligjshëm Vendimin Nr.34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si rezultat i këtyre mangësive nuk ka qenë i mundur trajtimi i ligjshmërisë së pretendimeve ankimore dhe vendosjes në mënyrë meritore lidhur me ankesën.

Kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që lënda të kthehet në rivendosje të organi i njëjtë, gjegjësisht Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila në procedurë të rishqyrtimit duhet t'i marr parasysh pikëpamjet juridike dhe t'i eliminoj të metat e konstatuara sipas këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.908/2021**

**Çlirim Zeka**  
  
Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj-Demi**  
  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesit av.
- Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Zyrën e Kryeministrit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

